

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 4602/5 prot.

Tiranë, më 11.11.2022.

Lënda : Dërgohet raporti përfundimtar i auditimit.

QENDRA E BOTIMEVE ZYRTARE

TIRANË

Në zbatim të programit të auditimit nr. 4602/1 prot., datë 25.08.2022, "Për auditimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare" të miratuar nga Drejtori i Auditimit, bashkëlidhur po ju dërgojmë raportin përfundimtar të auditimit, shoqëruar nga anekset perkatese (shtojca 1 dhe 2) si dhe planin e sygjëruar të veprimit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, mbi auditimin e kryer në njësinë Tuaj shpenzuese. Periudha e audituar është nga data **01.09.2018 deri më 30.06.2022**.

Në zbatim të nenit 12 të Ligjit nr.114, dt.22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", si dhe kapitulli VI, pika 4.1.12 të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar, detyroheni që raporti i auditit të jetë objekt analize në strukturat Tuaja.

Brenda 20 ditë pune nga marrja e raportit përfundimtar të auditimit duhet të dërgoni pranë Drejtorisë së Auditimit planin e veprimit të miratuar dhe të plotësuar me masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimit.

Drejtorja e auditimit në vijim **do të ndjekë dhe monitorojë zbatimin e rekomandimeve**, bazuar e në zbatim të kërkesave dhe procedurave të përcaktuara në Ligjin nr.114 datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", manualin e auditimit të brendshëm të miratuar nga Ministri i Financave nr.100 datë 25.10.2016 i ndryshuar, me udhëzimin e MFE nr.42 datë 27.10.2020 "Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik".



Duke ju falenderuar për bashkëpunimin Tuaj.


DREJTORI

Servet QOSHI

1

1





AUDITIM

QENDRA E BOTIMEVE ZYRTARE

RAPORT PERFUNDIMTAR I AUDITIMIT

PERIUDHA E AUDITUAR: 01.09.2018 DERI ME DATË
30.06.2022".

GENTJAN THOMA (PERGJEGJES GRUPI)

MAKSIM PAPA (AUDITUES)

Raport Përfundimtar Auditimi Financiar dhe Pëputhshmërie

“Mbi vlerësimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare dhe Sistemeve në Qendrën e Botimeve Zyrtare, për periudhën 01.09.2018 deri me datë 30.06.2022”.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

Në zbatim të planit vjetor të auditimit nr.5043/1, datë 12.10.2021 “Mbi miratimin e Planit Strategjik 2022-2024, si dhe Planit Vjetor të vitit 2022, të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Drejtësisë”, të miratuar nga Ministri i Drejtësisë, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Drejtësisë, si dhe në zbatim të programit të Auditimit të miratuar nga Drejtori i Auditit Z.Servet Qoshi me nr. 4602/1 prot, datë.25.08.2022 **“Për Auditimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”**, sipas objektit dhe llojit të auditimit, grupi i punës, kreu angazhimin e auditimit për vlerësimin e aktivitetit të këtij Institucionini .

Objekti kryesor i angazhimit të auditimit, është dhënia e opinionit për respektimin e legjislacionit në përdorimin e fondeve buxhetore, rregullshmëria e paraqitjes së dokumentacionit argumentues dhe justifikues nëpërmjet auditimit të përputhshmërisë së veprimeve dhe argumentimit të shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrave.

Qëllimi i misionit të auditimit është vlerësimi i sistemeve në tërësi dhe në veçanti për fushat me risk, ku kërkohet një vlerësim më i madh, përkatësisht; në praktikën e lidhjes dhe realizimit të kontratave, në fushën e prokurimeve, në fushën e pagesave për paga dhe për mallra e shërbime, në mbajtjen e kontabilitetit, në fushat e menaxhimit dhe administrimit të aktiveve, me qëllim dhënia e një informacioni të plotë titullarëve, për ecurinë e veprimtarisë ekonomike e financiare të institucionit dhe një vlerësim të drejtë, objektiv dhe të pavarur të aktiviteteve, në interes të zbulimit të mangësive e të metave dhe dhënien e rekomandimeve për eliminimin e tyre.

Periudha e Auditimit është nga data.**01.09.2018 deri më datën.30.06.2022**

Afati i auditimit është nga data.**29.08.2022 deri më datën.20.09.2022.**

HYRJE

Grupi i Auditimit, nisur nga qëllimi dhe objekti i misionit të auditimit, bazuar në Ligjin nr. 114 datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar, Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Miratimi i Manualit të Auditimit të Brendshëm”, Ligjin nr.10296, datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”..... etj, Drejtoria e Auditimit në Ministrinë e Drejtësisë, sipas programit të angazhimit të auditimit me nr.4602/1 prot, datë. 25.08.2022 **“Program i Angazhimit të Auditimi për Vlerësimin e Sistemeve në Qendrën e Botimeve Zyrtare”** të miratuar nga Drejtori i Auditimit, bëri vlerësimin e veprimtarisë së përputhshmërisë ligjore të këtij Institucioni, për periudhën nga data **01.09.2018 deri më datë**

- VKM-në nr.524, datë 16.08.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.545, datë 11.08.2011 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të nëpunësve të institucioneve të varësisë”;
- Vendimet e Këshillit të Ministrave dhe aktet e nxjerra nga Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë në zbatim të akteve të mësipërme.
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.284, datë 14.5.2014, “Për miratimin e rregullave të hollësishme për organizimin dhe për funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave elektronike të akteve”;
- Urdhrit të Kryeministrit nr.82, datë 17.6.2015, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Botimeve Zyrtare”, si dhe ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.214, datë 11.3.2015, “Për përcaktimin e afateve dhe të masave që duhet të merren në lidhje me ankesat për gabimet dhe defektet e botimit dhe të publikimit”;
- Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 11.3.2015, “Për mënyrën, format dhe procedurën e dërgimit të tekstit të akteve të botueshme në Fletoren Zyrtare, si dhe për formatin e shkruar në letër dhe formatin elektronik të tyre”;
- Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 11.3.2015, “Për formatin, kriteret teknike, procedurat e përgatitjes, ditët e botimit, tirazhin e kopjeve, mënyrën e vënies në qarkullim dhe shpërndarjen e Buletinit të Njoftimeve Zyrtare”;
- Udhëzimit të përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Financave nr.8451/4, datë 15.1.2015, “Për caktimin e çmimit dhe të tarifave të botimeve të Qendrës së Botimeve Zyrtare, si dhe institucionet që përfitojnë falas kopje të botuara të Fletores Zyrtare”;
- Urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr.607/1, datë 10.11.2014, “Për kriteret dhe mënyrën e botimit të Fletores Zyrtare”;
- Urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. 607, datë 10.11.2014, “Për krijimin e regjistrit shtetëror të akteve”;
- Urdhrit të ministrit nr.7717/1, datë 10.10.2018, “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe për funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”.

Standardet e auditimit : Ligjin nr. 114 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Miratimi i Manualit të Auditimit të Brendshëm” me ndryshime. Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik dhe Standardet duke përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë, konform me parimet, normat, rregullat dhe ligjet në fuqi.

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik dhe Standardet duke përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë së procesit të legalizimit dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare, konform me parimet, normat, rregullat dhe ligjet në fuqi.

1. Mos zbatimi i rekomandimeve (në masën 12%) sipas raportit përfundimtar të auditit referuar programit nr 9787 prot datë 27.09.2018, si dhe plan veprimit të dërguar nga ana e QBZ-së me shkresën nr 1251/4 datë 18.02.2019 , pranë Drejtorisë së auditit në MD.

2. Ka mangësi dokumentacioni në plotësimin e dosjeve të personelit sipas stojcës nr.1 të VKM-së nr.833 datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të rregjistrit qendror të personelit” me ndryshime.

3. Sipas opinionit të auditimit kërkohet që të në periudhën në vazhdim nga ana e QBZ së të zbatohen referencat ligjore të nenit 112, i Kodit Civil ku parashtron afatet për të kërkuar detyrimin, dhe të mos lihen për një periudhë jashtë afateve që parashikon ligji.

4. Zbatimin e procedurave për mbledhjen e detyrimeve dhe zbatimin e afateve ligjore në rast “Padie” nga ana e QBZ së duhej të ishte bërë brenda afateve ligjore të nenit 112, I Kodit civil parashtron afatet për të kërkuar detyrimin , si dhe nenit nr 7 të kontratës, midis palëve. Gjithashtu të zbatohen referencat ligjore sipas ligjit nenet 281 dhe 283 të KPr Penale dhe nenit 150 të Kodit penal.

5.Kallëzimi të përpilohej në formën e kërkuar sipas ligjit nenet 281 dhe 283 të KPr Penale , pasi nuk përmban elementët kryesorë të faktit , burimet e provës , gjeneralitetet,dhe cdo gjë tjetër që i adresohet personit që i atribohet fakti. Gjithashtu në kallëzim të përcaktohet saktë vlera e dëmit të shkaktuar nga pronarët e Trualit, kërkesë kjo e nenit 150 të kodit penal, e cila kërkon detyrimisht të përcaktohen pasojat materiale, por vetëm përmendet se janë dëmtuar paisjet e zyrave , mallra fletore zyrtare etj.

6. Nga ana e Institucionit të bashkërendohet puna me institucionin qendror për mundësinë e parkimit të makinës Toareg me targë TR 81-01K, në ambjente që disponon Ministria e Drejtësisë me qëllim shmangjen e pagës së parkimit. Me qëllim mirë menaxhimit e fondeve publike, në përmbushje gjithashtu të misionit dhe objektivat e njësisë publike: Referuar dhe ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” me ndryshime.

7. Zbatimi i nenit nr 40 i VKM së me nr 914 datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime, si dhe Udhëzimi i APP-së nr.3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” me ndryshime.

Kur ofertuesi i renditur në vend të parë tërhiqet nga oferta e tij ose nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor, ky i fundit përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave dhe kështu me radhë, deri në ofertuesin e renditur në vend të dhjetë. ***Këto veprime duhet të***

Grupi i auditimit referuar dhe pikave të programit të auditimit me nr 4602/1 prot, datë.25.08.2022 “Për Auditimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare” , për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve mori në shqyrtim rekomandimet sipas plan veprimit të paraqitur prane drejtorisë së auditimit dhe shqyrtoi zbatimin e tyre . Pas analizimit të zbatimit të rekomandimeve u pa se disa rekomandime nuk ishin zbatuar nga ana e QBZ së.

Analizimi i rekomandive dhe zbatueshmëria e tyre.

I. Rekomandimet e lëna në lidhje me sistemin e pagave dhe rekrutimeve.

Rekomandim I.1. Të kryhet zyrtarisht verifikimi i diplomes me nr. Regjistri 11433 datë 30 Tetor 2015, pranë Universitetit "LaSapienza" në Republikën e Italisë. Për rezultatet e konfirmimit, të njoftohet menjëherë Drejtoria e Auditimit e Ministrisë së Drejtësisë.

Opinion i QBZ së: Me shkresën nr.1251/7 prot, datë 21.02.2019 “Kërkesë për vënie në dispozicion të kopjes së diplomës së noterizuar Znj. Ardita Buna”, ku i është kërkuar znj.Buna noterizimi i diplomës dhe plotësimi I dokumentacionit të nevojshëm. Nga ana e Znj Buna më datë 06.03.2019 i është kthyer përgjigje QBZ së e i është vënë në dispozicion kopja e diplomës e universitetit “ La Sapienza” e noterizuar.

Opinion i Auditit. Sipas auditimit ky rekomandim është zbatuar.

Rekomandim.I.2

Të verifikohen të gjitha diplomat dhe të plotësohen dosjet e punës sipas rregullit me diploma të noterizuara. Ti kërkohet Znj. Ardita Alsules, kopje e diplomës e noterizuar, në rast mos plotesimi, të evidentohet shtesa e pages, si pagese e paguar padrejtësisht dhe të kthehet në buxhet.

Opinion i QBZ së; Me shkresën me nr.1251/8 prot, datë 04.03.2019 nga ana e QBZ së i është kërkuar informacion Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, Drejtorisë së Arsimit të Lartë në MAS, verifikimin e diplomës me gradë shkencore “ Doktor” me nr.regjistri 11433 datë 30.10. 2015 të znj. Alsula pranë Universitetit “ La Sapienza”. Ministria e Arsimit me shkresën me saj nr. 2704/ 1 prot, datë 13.03.2019 ka njohur dhe njehësuar në Republikën e Shqipërisë gradën “Doktor “ të Universitetit “ La Sapienza” me nr regjistri 407. Me urdhërin nr.45 datë 30.11.2016 “Shtesë page për shkak të mbrojtjes së titullit shkencor “ Doktor” ka përcaktuar efektet finasnciare për shtesën mbi pagë të fillojnë më datë 29.01.2016.Ministria e Drejtësisë pas korespodencës me Departamentin e Administratës Publike (DAP) ka miratuar të drejtën e shtesës mbi pagë për gradën “Doktor” për Znj Alsula .

Opinion i Auditit. Rekomandim i realizuar .

Të arkëtohet në buxhetin e shtetit, shuma 141,189 lekë nga përfituesit sipas urdhër pagesës me nr. 73 datë 30.05.2017 shuma 99,000 lekë ku është paguar shoqëria "Amadeus Travell and Tours" shpk për udhëtime me avion dhe hotel për 2 persona dhe 2 netë për vizitë pune në Romë Itali. Me urdhër pagesën me nr.70 datë 25.05.2017 janë paguar 30,269 lekë për dietat e punojësve jashtë vendit për 2.5 ditë qëndrim . Me urdhër pagesën nr.79 datë 01.06.2017 shuma prej 11,920 lekësh janë paguar shpenzimet e transportit dhe taksë e hotelit.

Opinion i QBZ së. QBZ ka vënë në dispozicion të grupit të auditimit dokumentacion sa mëposhtë;

- E-maili i datës 31 mars 2017 nga Forumit European i Fletoreve Zyrtare ku përcaktohet takimi i dytë më datë 19 maj 2017.
- E-maili i ardhur më datë 4 prill 2017 nga Forumit European i Fletoreve Zyrtare” ku konfirmon ndryshimin e takimit të dytë për më datë 26 maj 2017.
- Urdhëri nr.2531/1 i Ministrit të Drejtësisë datë 20.04.2017 ku pjesmarja në eventin “ Forumi European i Bashkimit European të Fletores Zyrtare në Europe” do të zhvillohet në datat 25 deri 27 maj 2017.
- Kërkesës për pjesmarje në “Forumin European të Bashkimit European të Fletores Zyrtare në Europe” me nr 547 datë 12.04.2017 drejtuar Ministrit të Drejtësisë ku parashikon pjesmarjen e dy punojësve të QBZ së .*Në këtë kërkesë nuk ka argumentuar mbulimin e shpenzimeve të këtij aktiviteti si transporti udhëtimi fjetja taksat ushqimi.*

Opinion i Auditit. Rekomandim I.4 Rekomandim i pa zbatuar.

- Urdhëri nr.2531/1 datë 20.04.2017 ku pjesmarja në eventin “Forumit European i Bashkimit European të Fletores Zyrtare në Europe” do të zhvillohet në datat 25 deri 27 maj 2017 *(Në urdhër nuk është cilësuar kush i mbulon shpenzimet për pjesmarje në aktivitet).*
- Argumentimi i kërkesës për pjesmarje në këtë aktivitet me nr.547 datë 12.04.2017 ku njësia shpenzuese *nuk ka argumentuar mbulimin e shpenzimeve të këtij aktiviteti.*

II. Zbatimi i rekomandimeve në lidhje me sistemin e menaxhimit buxhetor.

Rekomandimi II.1

Është kryer kontabilizimit sipas udhëzimit të Ministrit të Financave për mbajtjen e kontabilitetit. Është realizuar procedura e verifikimit të mënyres së kontabilizimit të dokumentave financiare, llogarisë 60200 “shpenzime”. Të analizohet në mënyrë të detajuar lëvizjet e kësaj llogarie, për të konkretizuar në se ka diferenca për tu kompesuar. Në përfundim të verifikimeve të urdhëruara, nëse nuk ka diferenca në vlerë, rekomandimi nuk gjen fushë zbatimi

Opinion i QBZ së. Me urdhërin nr 16 datë 18.02.2019 “Mbi ngritjen e komisionit të verifikimit” ku ka nisur procedura për verifikimin e kontabilizimit të dokumentave të llogarisë 60200 “Shpenzime të tjera personeli”.

Opinion i Auditit. Rekomandim II.1 I realizuoi.

Rekomandimi II.2

-Verifikimin e mënyrës së kontabilizimit të dokumentave financiare të llogarisë 35” Mallra”
-Procedura e verifikimit të kontabilizimit të dokumentave të llogarisë 60200 “Shpenzime”
-Analiza e këtyre llogarive për të parë nëse ka diferenca apo jo.
-Ekzistenca dhe saktësia e regjistrit të aktiveve të QBZ së ballafaquar me pasqyrat financiare.
Pasi analizoi pikat e urdhërit grupi i auditimit doli në konkluzion se ky rekomandim ishte zbatuar.
Opinionit i Auditit. Rekomandim III. 4 I realizuar.

Rekomandim III.5

Të mos kryhen shpenzime pa përshkruar mallin konkret ose shërbimin konkret që është kryer për institucionin.

Opinionit i QBZ së: Nga ana e Institucionit janë marë masa që çdo shpenzim/pagesë/likuidim të shoqërohet me process verbal marrje në dorëzim, ku të detajohen përshkrimi i mallit/shërbimit të përfituar

Opinionit i Auditit. Rekomandim III.5 I Realizuar

IV. Rekomandime ne lidhje me sistemin e prokurimeve dhe blerjet e vogla.

Rekomandim IV.1.

Drejtorit e Financës të mos kryej asnjë pagesë të procedurave të prokurimit "Blerje të vogla me sisteme elektronike nëpërmjet Bankës ", pa patur të bashkangjitur aktmarrveshjen në dorëzim.

Opinionit i QBZ së Komisioni i blerjeve të voglatë mbajë procesverbal për llogaritjen e fondit limit për çdo procedurë sipas parashikimeve të kuadrit ligjor për prokurimet.

Opinionit i Auditit. Rekomandim IV.1 I realizuar

Rekomandim IV.2

Për çdo procedure prokurimi të kryer nga Autoriteti Kontraktor të kryet përlllogaritja e fondit limit.

Opinionit i QBZ së. Komisioni i blerjeve të vogla të mbajë proces verbal për llogaritjen e fondit limit për çdo procedurë sipas parashikimeve të kuadrit ligjor për prokurimet.

Opinionit i Auditit. Rekomandim IV.2 I realizuar

Rekomandim IV.3

Në mënyrën e përzgjedhjes së operatorit ekonomik për blerje mallrash dhe kryerje shpenzimesh të zbatohen procedurat ligjore.

Opinionit i QBZ së. Marrja e masave që për çdo procedurë prokurimi, mënyra e përzgjedhjes së operatorit ekonomik të kryhet në zbatim të procedurave ligjore duke garantuar zbatimin e parimit të konkurrencës dhe barazisë në tendera.

Opinionit i Auditit. Rekomandim IV.3 I Realizuar

V. Rekomandime ne lidhje me sistemin e menaxhimit të riskut.

Gjetje .

Referuar pikave të programit nr.4602/1 prot, datë.25.08.2022, për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të audit të mëparshëm , u konstatua se nga ana e institucionit nuk ishin zbatuar rekomandimet e lëna nga auditimi i mëparshëm me programin e auditimit nr.9787 prot, datë 27.09.2018.

Rekomandim .

Zbatimin e Rekomandimeve të pa zbatuara (të cilat i kemi të analizuara më lart) të auditimit të mëparshëm. Referuar nenit 6 pika ç i ligjit nr 114/2015 “ Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Zbatimi i rekomandimeve sipas raportit përfundimtar të auditit referuar programit nr 9787 prot datë 27.09.2018, si dhe plan veprimit të dërguar nga ana e QBZ-së me shkresën nr 1251/4 datë 18.02.2019 , pranë Drejtorisë së auditit në MD .Kjo referuar dhe manualit të auditimit si dhe “Ligjit mbi auditimin e brendshëm” Zbatimi i rekomandimeve do të kontribuojë në përmirësimin e menaxhimit të risqeve ,të kontrollit dhe proceseve të qeverisjes.

Referuar pikës 4.1.13.1 *Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimi* sipas manualit të auditimit Në qoftë se njësia e audituar nuk përgjigjet me shkrim lidhur me pranimin dhe masat për zbatimin e rekomandimeve, drejtuesi i NjAB-së informon titullarin e njësisë publike, në fushën e përgjegjësisë shtetërore të të cilit bën pjesë njësia e audituar që menaxheri i lartë nuk ka përmbushur përgjegjësitë e tij ligjore.

Drejtoria e auditimit *do të ndjekë dhe monitorojë zbatimin e rekomandimeve*, bazuar e në zbatim të kërkesave dhe procedurave të përcaktuara në Ligjin nr 114 dt 22.10.2015 Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, manualit të Auditit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr .100 datë 25.10.2016 i ndryshuar, me udhëzimin nr.42 datë 27.10.2020 ‘Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik’.

Titulli i Gjetjes: Mos zbatimi nga ana e Institucionit të rekomandimeve të auditit të mëparshëm..

Gjetje nr. 1.	Kontrolli i Brendshëm.
Subjekti i Audituar	Qendra e Botimeve Zyrtare
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	Qendra e Botimeve Zyrtare.
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” Ligjin nr 114 dt 22.10.2015 Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, manualit të Auditit të Brendshëm , miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr .100 datë 25.10.2016 i ndryshuar, me udhëzimin nr.42 dt 27.10.2020 ‘Për

sipas gjetjes së grupit të auditimit.Referuar dokumentacionit rezulton se nuk është i saktë dhe konform ligjit pasi ka mangësi dhe konkretisht;

- Argumentimi i kërkesës për pjesmarje në këtë event me nr 609 datë 24.04.2017 ana e QBZ ***nuk ka të argumentuar mbulimin e shpenzimeve të këtij aktiviteti sic janë transporti djetat dhe fjeta në hotel..***
- Datat për pjesmarje në aktivitet janë **1 – 2 Qershor 2017** kurse kërkesa nga ana e QBZ së drejtuar Ministrit të Drejtësisë përcakton datat 31 Maj deri 4 Qershor 2017 , ***kemi tejkalim të datave në pjesmarje të aktivitetit si rjedhojë janë përfituar mjete monetare (si djeta , hotel taksa) në kundërshtim me ligjin.***

Rekomandim.I 4

Të arkëtohet në buxhetin e shtetit, shuma 141,189 Lekë nga përfituesit.

Opinion i QBZ së. QBZ ka vënë në dispozicion të grupit të auditimit dokumentacion sa mëposhtë;

- E-maili i datës 31 mars 2017 nga Forumit European i Fletoreve Zyrtare ku përcaktohet takimi i dytë më datë 19 maj 2017.
- E-maili i ardhur më datë 4 prill 2017 nga Forumit European i Fletoreve Zyrtare” ku konfirmon ndryshimin e takimit të dytë për më datë 26 maj 2017.
- Urdhëri nr 2531/1 i Ministrit të Drejtësisë datë 20.04.2017 ku pjesmarja në eventin “ Forumi European i Bashkimit European të Fletores Zyrtare në Europe” do të zhvillohet në datat 25 deri 27 maj 2017 .
- Kërkesës për pjesmarje në “ Forumin European të Bashkimit European të Fletores Zyrtare në Europe”me nr 547 datë 12.04.2017 drejtuar Ministrit të Drejtësisë ku parashikon pjesmarjen e dy punojësve të QBZ së ***Në këtë kërkesë nuk ka argumentuar mbulimin e shpenzimeve të këtij aktiviteti si transporti udhërimi fjetja taksat ushqimi.***

Opinion i Auditit. Rekomandim I.4 I pa zbatuar.

- Urdhëri nr 2531/1 datë 20.04.2017 ku pjesmarja në eventin “ Forumi European I Bashkimit European të Fletores Zyrtare në Europe” do të zhvillohet në datat 25 deri 27 maj 2017 (***Në urdhër nuk është cilësuar kush i mbulon shpenzimet për pjesmarje në aktivitet)***

Të arkëtohet në buxhetin e shtetit, shumat e pajustificuara nga përfituesit, 402,332 Lekë; dhe 78,700 Lekë.

Opinion i QBZ së . Sipas QBZ së pjesëmarrësit paraqitën dokumentacion për vërtetimin e angazhimit të tyre në këto aktivitete. U vërtetua se pjesëmarrësit nuk kishin përvetsuar padrejtësisht këto shuma.

Dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit si mëposhtë;

- Shkresa nr 609 datë 24.04.2017 ana e QBZ së drejtuar Ministrit të Drejtësisë “Kërkesë për miratim pjesmarje në takimin vjetor të Forumit Europian të Fletoreve Zyrtare në Maltë” , ku kërkohet pjesmarja në këtë aktivitet nga data 31 maj 2017 deri në 4 qershor 2017, të 4 personave nga QBZ.
- E-maili i forumit Europian i Fletoreve Zyrtare i datës 21 prill 2017 që parashikon pjesmarjen në këtë event nga datat 1-2 qershor 2017 të aktivitetit.

Opinion i Auditit. Rekomandim I.3 I pa zbatuar.

Referuar gjetjes së grupit të auditimit ku kërkohet arkëtimi i shumave të mësipërme , nuk u paraqit ndonjë dokumentacion nga ana e palës së audituar për arkëtimin e tyre.QBZ ja shprehet vetëm me faktin se nuk ka përvetësim të pa drejtë të këtyre shumave se dhe gjithcka është konform ligjit por pa e justifikuar plotësisht sipas gjetjes së grupit të auditimit.Referuar dokumentacionit rezulton se nuk është i saktë dhe konform ligjit pasi ka mangësi dhe konkretisht;

- Argumentimi i kërkesës për pjesmarje në këtë event me nr 609 datë 24.04.2017 ana e QBZ ***nuk ka të argumentuar mbulimin e shpenzimeve të këtij aktiviteti sic janë transporti djetat dhe fjeta në hotel..***
- Datat për pjesmarje në aktivitet janë **1 – 2 Qershor 2017** kurse kërkesa nga ana e QBZ së drejtuar Ministrit të Drejtësisë përcakton datat 31 Maj deri 4 Qershor 2017 , ***kemi tejkalim të datave në pjesmarje të aktivitetit si rjedhojë janë përfituar mjete monetare (si djeta , hotel taksa) në kundërshtim me ligjin.***

Rekomandim.I 4

Të arkëtohet në buxhetin e shtetit, shuma 141,189 Lekë nga përfituesit.

- **Vlerësimi i mjedisit të kontrollit, planifikimi dhe menaxhimi i riskut .kontrolli i aktiviteteve dhe monitorimi i tyre.**

Është hartuar dhe miratuar regjistri i riskut, ku për secilin nga objektivat janë përcaktuar "përshkrimi i riskut", "risku para kontrollit", "masat zbatuese", "implementimi i masave zvogëluese të vlerës së riskut", "afati i përfundimit për implementimin", "statusi", "vlera e riskut pas masave", "qëndrime ndaj riskut", si dhe është realizuar harta e riskut.

Nga auditimi u konstatua se vlerësimi i punonjësve realizohet një herë në vit dhe ishte i dokumentuar në dosjet e personelit. Shkresa me nr 353/2 datë 22.03.2019 (vendimi nr 22/2 datë 22.03.2019“ **Për miratimin e strategjisë së riskut për Qendrën e Botimeve Zyrtare Viti 2019**”. Shkresa nr 306/1 datë 18.02.2021 (Vendimi nr 1 datë 18.02.2021) “ **Për miratimin e strategjisë së riskut për Qendrën e Botimeve Zyrtare Viti 2021**”., kjo referuar dhe ligjit nr 78/2014 datë 17.10.2014 “ Për organizimin dhe funksionimin e QBZ së , si dhe ligjit nr 10296 datë 08.07.2010 “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” me ndryshime.

QBZ ka një rregullore të brendshme të institucionit, si dhe ka të dokumentuar ndarje detyrash për sektorët e tjerë (përfshirë bën sektori i financës i cili ka një ndarje të detyrave dhe përgjegjësi) sipas formatit të miratuar dhe bazuar në *Parimin 12 Aktivitetet e Kontrollit “Vendosja e aktiviteteve të kontrollit përmes politikave dhe procedurave”*. *Aneksi 2, 3 dhe 4 i Manualit të Menaxhimit Kontrollit Financiar*. Me urdhërin nr 7717/1 datë 10.10.2018 , Eshtë miratuar nga ana e Ministres së Drejtësisë Regullorja e Brendshme e QBZ së. Sektori i Financës ka një ndarje të detyrave funksionale midis Përgjegjësit të Sektorit të Financës dhe specialistit të financës.

Veprimtaritë e kontrollit përmbajnë, minimalisht: b) ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave të cilat janë zbatuar nga ana e këtij institucioni. Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit janë realizuar bazuar në udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011, i ndryshuar “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike”.

VII. Monitorimi i zbatimit të Buxhetit

Respektimi i disiplinës buxhetore sipas titujve, kapitujve, artikujve.

Respektimi i autoriteteve dhe procedurave për ndryshimet në buxhet.

Për vitin 2018.

Baza ligjore;

Akti normativ nr.1 datë 26.07.2018 “ Për disa ndryshime në ligjin nr.109/2017 “ Për Buxhetin e vitit 2018 “ të ndryshuar. Udhëzimi Nr.2, datë 19.01.2018” Për procedurat standarte të buxhetit

Realizimi i buxhetit viti 2018 sipas zërave .

- **Artikulli 600** “Paga personeli dhe shpërblime”, nga **25,870,720 lekë**, është realizuar **25,543,864 lekë**, ose **88%**. Me mosrealizim në shumën **326,856 lekë**,
- **Artikulli 601** “Kontribute për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore”, nga **4,285,000 lekë**, është realizuar **4,243,101 lekë**, ose, **99%**. Me mosrealizim në shumën **41,899 lekë**.
- **Artikulli 602** “Shpenzime operative”, nga **14,000,000 lekë**, është realizuar **12,860,934 lekë**, ose **91%**. Me mosrealizim në shumën **41,899 lekë**,
- **Artikulli 606** “Shpenzime Korrente” planifikuar në shumën **344,280 lekë** është realizuar **344,280** ose **100%**.

Përdorimi i fondit të vecantë ku për vitin 2018 është kryer pagesë dëmshpërblimi për punojësen e këtij institucioni pas ristrukturimit me urdhër pagesë nr 61/1 datë 07.11.2018 në shumën 344,280 lekë.

Të ardhurat dytësore viti 2018.

Për vitin 2018 QBZ ja ka realizuar të ardhura nga shitja e shtypshkrimeve fletore zyrtare , kopje akti dhe abonime në shumën **2,789,553 lekë**. Të ardhurat dytësore së siguruara nga ana e QBZ së janë kanalizuar nëpërmjet veprimeve bankare të nivelit të dytë.

Për vitin 2019.

Baza ligjore.

Akti normativ nr 2 datë 02.10.2019 “ për disa ndryshime në ligjin nr 99/2018 “ Për Buxhetin viti 2019 “ të ndryshuar.Udhëzimi Nr.2, datë 19.01.2018” Për procedurat standarte të buxhetit viti 2018“ udhëzim nr 9 datë 20.03.2018 Për procedurat standarte të buxhetit viti 2018“ . Ligji nr 9936 datë 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”.

Me shkresën nr 130/3 prot datë 15.08.2018 “ Dërgohen pasqyrat për projekt buxhetin afat mesëm dhe afatgjatë viti 2019-2021 për QBZ në”

Në zbatim të aktit normativ Nr 2 datë 02.10.2019 për shpenzimet kapitale , sipas shkresës me nr 774/2 datë 05.12.2019 , në vijimshëri të shkresës nr 17343/157 datë 18.11.2019 të MFE , është miratuar limiti për pakësimin e zërit “ Shpenzime Kapitale” Akti normativ Nr 2 datë 02.10.2019 I është përcjellë nga ana MFE ministrisë së Drejtësisë me shkresën nr.17343/149 prot, datë 08.11.2019.

Me shkresën nr.1688 prot, datë 20.02.2019 nga ana e MD së është dërguar pranë QBZ së detajimi i buxhetit për shpenzimet korrente dhe kapitale viti 2019, në vijimësi të shkresave nr.22760/200 prot datë 29.01.2019 dhe shkresës nr.22760/209 prot, datë 30.01.2019 për detajimin e shpenzimeve koerrente dhe kapitale viti 2019.Nga ana e MD së me shkresën nr 1094/1 datë 07.09.2019 dhe në mbështetje të shkresës nr 22760/200 të ardhur nga MFE ja është dërguar pranë

Zëri 231 "Investime" është realizuar në masën 100 %.

Përdorimi i fondit të vecantë për vitin 2019 është shpenzuar 50,000 lekë ,pagesë punojësish në rast sëmundjeje, me urdhër pagesën nr.55 datë 18.11.2019.

Të ardhurat dytësore viti 2019.

Për vitin 2019 QBZ ja ka realizuar të ardhura nga shitja e shtypshkrimeve fletore zyrtare , kopje akti dhe abonime në shumën **4,435,242 lekë**. Të ardhurat dytësore së siguruara nga ana e QBZ së janë kanalizuar nëpërmjet kanaleve bankare.

Për vitin 2020.

Baza Ligjore.

Akti normativ nr.34 datë 16.12.2020 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019 " Për buxhetin viti 2019 " të ndryshuar. Udhëzimi Nr.9, datë 20.03.2018" Për procedurat standarte të buxhetit " I ndryshuar. Ligji nr 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH".

Nga ana e MD së me shkresën nr 563/2 datë 18.02.2020 dërgohet detajimi i nr të punojësve për vitin 2020, kjo në funksion të shkresës nr 24334/34 prot datë 31.01.2020 të MFE së.

Me shkresën nr 833/4 datë 04.03.2020 "Dërgohet detajimi I buxhetit për periudhën 2020-2022 për shpenzimet korrente dhe kapitale QBZ së. Nga ana e MFE me shkresën nr 2169/10 datë 24.02.2020 ka ardhur pranë MD së dhe QBZ së detajimi I buxhetit të vitit 2020-2022 për shpenzimet kapitale, kjo dhe në mbështetje të shkresës nr 833/1 datë 10.02.2020 për miratimin e shpenzimeve kapitale për periudhën 2020-2022 ku për vitin 2020 vlera 5,000,000 lekë.MFE me shkesën nr 24325/237 datë 25.02.2020 I ka dërguar degës së thesarit dhe MD së detajimin e buxhetit për shpenzime koerente viti 2020-2022 .

MD ja me shkresën nr 873/3 datë 06.03.2020 ka dërguar pranë QBZ së detajimin e limitit mujor për shpenzime korrente për vitin 2020, kjo në vijishmëri të shkresës së ardhur nga MFE ja me nr 24325/24 dt 02.03.2020.

Me shkresën nr 2373 prot datë 22.04.2020 të MD së drejtuar QBZ së dërgohet detajimi I limitit mujor për vitin 2020 , kjo në vijushmëri të shkresës së ardhur nga MFE ja me nr 2169/28 prot datë 03.03.2020.(QBZ 5,000,000 lekë).

Ministria e Drejtësisë me shkresën nr 1803/1 datë 02.04.2020 drejtuar QBZ së ka dërguar ndryshimin e planit të buxhetit në zbatim të aktit normativ Nr 6 datë 21.03.2020, kjo në vijushmëri të shresës nr 5800/1 prot datë 24.03.2020 të MFE së.Ku sipas aktit normativ akordohet shuma 2,947,000 lekë.

Për vitin 2021.

Baza Ligjore: *Akti normativ nr.137 datë 24.12.2020 "Për buxhetin vitit 2021" të ndryshuar. Udhëzimi Nr.4, datë 25.01.2021 " Për procedurat standarte të buxhetitviti 2021 " i ndryshuar. Ligji nr 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH"*

Shkresa me nr.126/2 datë 26.08.2020 " Dërgohet pasqyrat e programit buxhetor afatmesëm viti 2021-2023.

Në vijimësi të shkresës nr.18021/1 prot, datë 27.10.2021 të MFE së, si dhe shkresës nr.5052/82 prot, datë 01.11.2021 është miratuar fondi i vecantë për QBZ në vlerën 59,750 lekë.

Në vijim të shkresës nr 1846/2 datë 12.04.2021 të MFE së " Transferim fondi" e cila përcillet pranë QBZ së me shkresën me nr.1846/3 datë 19.04.2021ku QBZ së i pakësohet zëri buxhetor 602 në vlerën 24,000 lekë dhe shtohet zëri 606 në vlerën 24,000 lekë.

Në vijim të shkresës së MFE së me nr.1381/1 prot, datë 15.02.2021 e cila përcillet nga ana e MD së me shkresën nr.797/4 prot datë 25.02.2021 pranë QBZ së autorizohet QBZ ja që shtesat dhe pakësimet të bëhen në muajin aktual . Me shkresën nr 1381/15 datë 11.02.2021 e MFE së është dërguar detajimi i fondit të vecantë në vlerën 200,000 lekë.

Me shkresën nr 594/2 të MD së dërgohet detajimi i buxhetit për shpenzimet kapitale viti 2021 dhe 2023 pranë QBZ së, kjo në vijueshmëri të shkresës së ardhur nga MFE ja me nr. 23724/184 datë 27.01.2021 ,vlera 10,000,000 lekë.

Me shkresën nr 535 datë 27.01.2021 dërgohet nga MD ja pranë QBZ së detajimi i buxhetit për vitet 2021 -2023 për shpenzimet korente, kjo në vijueshmëri të shkresës nr.23724/95 prot datë 18.01.2021 të MFE së.

Realizimi i buxhetit viti 2021 sipas zërave.

- **Artikulli 600** "Paga personeli dhe shpërblime", nga **27,274,000 lekë**, është realizuar **27,084,334 lekë**, ose **99 %**. Me mosrealizim në shumën **189,666 lekë**,
- **Artikulli 601** "Kontribute për Sigurimet Shoqerore dhe Shëndetësore", nga **4,544,000 lekë**, është realizuar **4,513,092 lekë**, ose, **99 %**. Me mosrealizim në shumën **30,908 lekë**.
- **Artikulli 602** "Shpenzime operative", nga **8,676,000 lekë**, është realizuar **8,022,588 lekë**, ose **93 %**. Me mosrealizim në shumën **653,412 lekë**.
- **Artikulli 606** "Shpenzime Korrente" planifikuar në shumën **283,750 lekë** është realizuar **282,475** ose **100 %**.

Mos realizimi i buxhetit në zërin 231 "Investime", ka ardhur si rezultat i mosrealizimit të procedurës së prokurimit nga AKSHI brenda vitit buxhetor 2021. Përdorimi i fondit të vecantë për vitin 2021 është paguar në shumën 242,485 lekë , ku janë kryer pagesa për raste sëmundjeje dhe fatkeqesisht dhe dalje në pension.

Të ardhurat dytësore viti 2021.

datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit të shtetit” i ndryshuar si dhe çdo akt tjetër ligjor e nënligjor që lidhen me zbatimin e buxhetit për të gjithë periudhën objekt auditimi.

Nisur nga fakti, që për periudhën e auditura 2018-2022 janë kërkuar shtesa e pakësim në artikuj e n/artikujt e buxhetit, tregon dhe vërteton se parashikimi i nevojave për fonde buxhetore është bërë me rezerva dhe plotësimi i tyre nuk është bërë sipas kërkesave.

Auditim mbi pagat e punonjësve dhe strukturën organike.

Grupi i auditimit në përfundim të auditimit, duke u bazuar në analizimin e gjithë dokumentacionit të paraqitur nga ana e degës së financës për çdo sektor mbështetës në këtë institucion, si dhe në vlerësimin në tërësi të veprimtarisë së institucionit, sipas Manualit të Auditimit të Brendshëm, mund të shprehemi se nuk kemi konstatuar probleme .

Përcaktimi i pagave: U audituan pagat e punonjësve në Aparatin e Qendrës së Botimeve Zyrtare, të cilat përcaktohen sipas funksionit dhe kategorisë bazuar në VKM-së nr.187 dt.03.03.2017 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Niveleve të Pagave të Nëpunësve civilë/nëpunësve”, Zëvendësministrit dhe Nëpunësve të Kabineteve, në Kryeministri, Aparatet e Ministrive të linjës, Administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të Ministrave të linjës dhe Administratën e Prefektit”, pika 1/3b dhe sipas lidhjes 1 i këtij vendimi përcakton kategoritë e pagave sipas pozicioneve të punës, tabela bashkëlidhur këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Paga e punonjësve mbështetës është përlogaritur bazuar në VKM Nr.202 datë.15.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.717 datë.23.06.2009, “Për Pagat e Punonjësve Mbështetës të Institucioneve Buxhetore”, lidhja I/1 deri me datë.20.04.2022, pasi pas kësaj date janë realizuar pagesat sipas VKM nr.234 datë.20.04.2022, “Për Pagat e Punonjësve Mbështetës dhe të Punonjësve të tjerë të Specialiteteve të Ndryshme në disa Institucione të Administratës Publike”, kreu I/1 si dhe në Udhërin e Kryeministrit, Urdhëri nr 55 datë.20.04.2022 “ Për një Ndryshim në Urdhërin Nr.82 datë.17.06.2017 “Për Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Qendrës së Botimeve Zyrtare ” të Kryeministrit, ku thuhet se : emërtesa në pozicionin – Operator ndryshohet me emërtesën – Faqosës/e.

Nuk u konstatuan parregullsi në përputhshmërinë e diplomës me pozicionin e punës dhe se përcaktimi i pagës së grupit është realizuar konform llojit të diplomës të gjendur në dosjen e personelit, ku përcaktohet qartë vlera e pages për çdo grup diplome të arsimit universitar duke i përcaktuar në tre grupe, konform vendimit sa më sipër.

pagesave. Gjatë krahasimit midis përmbledhëses së listë-pagesave me likujdimet në bankë u konstatua se veprimet dhe shumat e shpenzimeve për pagat për periudhën e audituar ishin të barabarta dhe pa diferenca.

U realizua verifikimi me përzgjedhje disa punonjës të institucionit, mbi pagesat neto të bëra në llogaritë personale të tyre në banka, duke i krahasuar me pagat neto në listëpagesa, në përfundim rezultoi se nuk pati diferenca. Nga ana e Sektorit të Financës është mbajtur libri i pagave në mënyrë elektronike dhe është plotësuar për të gjithë punonjësit në marrëdhënie pune, duke pasqyruar të gjitha të dhënat e kërkuara.

Nga krahasimi i librit të pagave me regjistrin themeltar sipas viteve, për rakordimin e numrit të punonjësve të paguar me atë të përfshirë në regjistër dhe nuk pati parregullsi. Grupi i auditit bëri verifikime me zgjedhje në lidhje me regjistrimin e punonjësve me kontratë dhe rezultoi se janë të regjistruar në regjistrin themeltar si dhe në librin e pagave.

Gjithë pagesat, janë shoqëruar me dokumentacionin mbështetës si listëprezencat, urdhrat e veçantë të titullarit si dhe janë nënshkruar nga drejtuesi kryesor të gjithë listëprezencat dhe urdhër shpenzimet për paga. Urdhër shpenzimet janë nënshkruar edhe nga dega e Thesarit Tiranë si dhe janë kryer ndalesat, të cilat janë derdhur në Degën Rajonale të Tatimeve.

Nga auditimi i realizuar në lidhje me përlllogaritjet e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të përballuara nga punëmarrësi dhe ato të përballuara nga punëdhënësi, deklaratimet, ndalesat si dhe derdhjet e tyre janë bërë në përputhje me ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7770, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.

Vlerësimi i procedurave dhe rregullave në dokumentimin e vlerave monetare, zbatimi i ligjeshmërisë për veprimet e kryera nëpërmjet bankës.

Objektivi i auditimit ka qenë, vlerësimi i procedurave dhe rregullave në dokumentimin e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës, përputhshmëria e këtyre veprimeve me ligjet dhe rregullat e vendosura. Auditimi i aktivitetit të bankës u krye i plotë, për periudhën 01.08.2018 deri me 30.06.2022. Urdhër shpenzimet për periudhën objekt auditimi janë nënshkruar nga punonjësia znj. Gladiola Kokonozi, në cilësinë nëpunësit zbatues (kontabilisti sipas mod të urdhër shpenzimit) dhe nga drejtuesia Etleva Haxhia, në cilësinë e nëpunësit autorizues të njësisë shpenzuese.

Auditimi i rregullshmërisë së veprimeve të kryera me bankë për vitit 2018-2022.

Auditimi i aktivitetit të bankës pati si objektiv, kontrollin e njëpasnjëshëm të transaksioneve të bankës të nënshkruara nga personat e autorizuar, mbështetur në dokumentacionin ligjor, besueshmërinë e pagesave

- Bashkëlidhur listëpagesave, gjendet dokumentacioni tjetër justifikues, si kohëshënuesi, urdhra të titullari, raporte mjekësore, etj., të nënshkruara nga specialisti dhe shefi Financës, si dhe Titulli i QBZ-së.

Nga auditimi i hartimit të listëpagesave, për përputhmërinë me kërkesat e legjislacionit të mësipërm, rezultoi, sa më poshtë;


- Listëpagesat, për të gjithë periudhën e audituar janë përgatitur nga specialisti i financës dhe janë të nënshkruara nga shefi i sektorit të financës dhe nga titullari.
- në përgatitjen e list-pagesave, janë respektuar kërkesat e udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011, *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”* ndryshuar dhe udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr.4, datë 13.12.2016 *“Për formën, elementët dhe plotësimin e bordosë së pagave për njësitë e qeverisjes së përgjithshme”*.
- Listëpagesat janë përgatitur në përputhje me organikën (limitin e punonjësve për efekt buxheti), pagën për vjetërsi pune, pagës për kategori (pozicion pune) për punonjësit civil me arsim të lartë dhe pagës për klasë për punonjësit mbështetës dhe nuk u konstatuan pagesa jashtë organikës dhe numrit limit të miratuar.

Struktura e miratuar dhe numri i punonjësve për gjithë periudhën e audituar.

Grupi i auditimit bazuar ne programin e auditimit miratuar nga Drejtori i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Drejtësisë, pika III/4 – Respektimi i organikës dhe limiteve të miratuara, realizoi auditimin ne lidhje me riorganizimi i strukturës organike në Qendrën e Botimeve Zyrtare – Tiranë, miratuar me Urdhërin e Kryeministrit, (duke përfshirë dhe ndryshimet në vite), si vijon :

Struktura dhe Organika epunonjësve në Qendrën e Botimeve Zyrtare, është realizuar bazuar në Urdhërin e Kryeministrit, Urdhër nr.82 datë.17.06.2017 *“Për Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Qendrës së Botimeve Zyrtare”*, ku thuhet se:

1. Struktura e Qendrës së Botimeve Zyrtare të jetë sipas skemës



Me shkresën nr.781/2 prot. Datë.01.06.2022, lënda 'Kërkesë për shpalljen e kriterëve për pozicionin e Përgjrgjësit të Sektorit të Shtypshkronjës pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare', drejtuar Departamentit të Administratës Publike – Tiranë, ku në këtë kërkesë përcaktohen qartë pozicion, përshkrimi i pozicionit të punës, kriterë të veçanta, fushat e njohurive, aftësive dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet konkurimi. Priten plotësimi i organikes sipas procedurave ligjore që do të organizohen nga strukturat e DAP.

Në zbatim të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, të Vendimit të Këshillit të Ministrave, VKM nr.16 datë.16.01.2019, "Për Përcaktimin e Numrit të Punonjësve me Kontratë të Përkohshme për vitin 2019, në Njesitëe Qeverisjes Vendore, Qendra e Botimeve Zyrtare shpall konkurimin për vend të lirë pune në pozicionin – Operator/e, me kontratë të përkohshme për 1 (një) muaj, për vitin 2019.

Njoftimi është bërë në faqen zyrtare të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Tiranë, me Shkresën nr.124 prot. datë.29.01.2019, dërguar nga Qendra e Botimeve Zyrtare, e rezulton se janë respektuar të gjitha procedurat ligjore dhe afatet kohore të përcaktuara në kërkesat e VKM-së.

Largimet nga puna, mënyra e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Grupi i auditimit realizoi auditimin e gjithë dokumentacionit për periudhën 01 shtator 2018 deri më 30 qershor 2022, në lidhje me zbatimin e procedurave dhe afateve në përputhje me dispozitat ligjore për largimet në këtë institucion, në perfundim të auditimit rezultoi se:

Janë larguar 8 (tetë) punonjës gjithësej, nga këta 5 (pesë) punonjës/e me status të nënpunësit civil, procedurat nga DAP-i, në këto pozicione – Specialist IT, Korrektore, Redaktore, Specialiste për Informacionin Ligjor me Publikun si dhe Shef Sektori i Shtypshkronjës. Janë larguar 3 (tre) punonjës me Kod Pune në këto pozicione - Faqosës/e dhe Operator/e.

6 Dosjet e personelit.

Duke ju referuar VKM Nr.833 datë 28.10.2020 "Për Rregullat e Hollësishme për Përmbajtjen, Procedurën dhe Administrimin e Dosjeve të Personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit", pika I/1, ku thuhet se Institucionet e Administratës Shtetërore, Institucionet e pavarura dhe të Vetqeverisjes Vendore, janë të detyruara të krijojnë dhe administrojnë dosje për gjithë personelin e punësuar në Institucionin e tyre. Sipas pikës II/3- Njësia e Burimeve Njerzore të cdo institucioni, sikurse dhe tek ky institucion, përgjigjet për mbajtjen, plotësimin dhe administrimin e dosjeve të personelit për cdo te punësuar.

U realizua auditimi i gjithë dosjeve të personelit, gjithësej 34 (tridhjetë e katër) dosje, auditimi i dosjeve të personelit u shtri në dy drejtime:

- 1) auditim i përputhshmërisë së diplomës me pozicionin e punës;
- 2) auditim i pagës së grupit me llojin e diplomës;

Bazuar ne vkm sa më sipër, lidhja 1, ku thuhet se të dhënat dhe dokumentacioni i dosjes së personelit duhet të përfaqësojë dokumentacionin si më poshtë vijon :

1. Fletë prezantuese e plotësuar sipas lidhjes nr.2

Gjetje nr. 2.	Sistemi i Rekrutimit dhe Pagave.
Subjekti i Audituar	Qendra e Botimeve Zyrtare
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	Qendra e Botimeve Zyrtare.
Përmbledhja e bazës ligjore	VKM-së nr.833 datë 28.10.2020 “Për Rregullat e Hollësishme për Përmbytjen, Procedurën dhe Administrimin e Dosjeve të Personelit e të Regjistrimit Qendror të Personelit” Plotësimi i dosjeve të personelit sipas stajcës nr 1 të VKM-së nr.833 datë 28.10.2020
